

Gjykata Themelore në Gjilan- Dega në Kamenicë, përmes gjyqtarit Burim Shala, me sekretarin juridik Ardian Sermaxhaj në çështjen kontestimore të paditësit S.N. nga ..., të cilin me autorizim e përfaqëson av.R.B. nga ... kundër të paditurit Q.D. nga ... , për shkak të pengim posedimit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor më datë 07.07.2014, mori këtë :

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.N., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri Q.D. e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe të pa penguar në paluajtshmërinë e paditësit në pjesën e ngastrës me sipërfaqe 5.5 metra gjatësi dhe thellësi në pronën e paditësit prej 0.15 - 0.25 cm, i cili gjendet në kufirin ndarës ndërmjet pronës së paditësit dhe të paditurit në atë mënyrë që e ka penguar paditësin në vendosjen e rrethojës në murin ndarës dhe prerjen e drunjve dhe vendosjen e të njëjtave në këtë pjesë ku është e vendosur garazha e paditësit dhe ti urdhërohet të paditurit që në të ardhmen të mos ndër marr apo kryej ndonjë veprim me të cilin do ta pengonte paditësin në shfrytëzimin e qetë dhe të pa penguar të paluajtshmërisë ngastrës kadastrale – nr .01625-6.

Shpenzimet gjyqësore bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Paditësi S.N. përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi në këtë gjykatë për shkak të pengim posedimit.

Në seancën për shqyrtim kryesor i autorizuari i paditësit ka mbetur në tërësi pran padisë duke theksuar se paditësi me të paditurin janë fqinjë dhe ngastrat e tyre kufizohen me njëra tjetrën, i padituri e ka kërcënuar paditësin që ai të mos i vendos drunj të e prera në pjesën e ngastrës së paditësit, po ashtu nuk e ka lejuar ta vendos edhe rrethojën e telit, ka propozuar gjykatës që të dalë në vendin e ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë si dhe në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet T.D., ndërsa si prova material të lexohet skica e terrenit e punuar nga gjeodeti N.R. si dhe certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.1555/13, pas administrimit të këtyre provave i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të aprovohet si e bazuar.

I padituri Q.D. e ka kundërshtuar në tërësi kërkesë padinë duke theksuar se nuk është e vërtetë që e kam penguar të paditurin ti vendos drunj të në ngastrën ku kufizohet me murë, po ashtu nuk është e vërtetë që nuk e kam lënë ta vendos telin rrethues pasi që teli rrethues është i imi dhe është i vendosur aty që nga viti 1970, i padituri ka dashur që drutë ti pres me makinë-

cerkullar të adaptuar për prerje të drunjëve por nuk ka mundur të hyjë me te në ngastrën e tij dhe është futur në ngastrën time afër dritares së shtëpisë dhe unë nuk e kam lejuar se ajo pjesë është e imja, ka propozuar gjykatës që në cilësi të provës material të lexohet marrëveshja gjyqësore C.nr.484/1980, ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të refuzohet si e bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat e propozuara nga palët si në cilësi ekspertit të gjeodezisë ka dëgjuar N.R., ndërsa në cilësi të dëshmitarit ka dëgjuar T.D., në cilësi të provave material ka lexuar skicën e terrenit punuar nga gjeodeti N.R. certifikatën mbi të drejtat në pronën e paluajtshme nr.1555-13, si dhe marrëveshjen gjyqësore C.nr.484/1980, dhe pas vëzhgimit të gjykatës në vendin e ngjarjes duke u mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, gjykata i ka vlerësuar provat një nga një dhe të tërat bashkarisht dhe ka gjetur se kërkesë padia e paditësit është e pa bazuar.

Në këtë çështje kontestuese nuk kanë qenë kontestuese faktet se paditësi me të paditurin janë në kufinj gjegjësisht fqinjë dhe oborret e shtëpisë së tyre kufizohen me njëri tjetrin, dhe janë të ndarë me murë rrethues prej betoni, po ashtu palët nuk e kanë kontestuar faktin se muri rrethues i ndanë trojet e tyre, por kontestues ka qenë fakti se a ka të drejtë paditësi që ngastrën e tij por mbi murë apo ngjitur me murë të ndërtoj garazh, për veturë apo edhe të vendosë drunjte për ngrohje por edhe të vendos rrethojë mbi mur ndarës.

Gjykata duke i marr parasysh faktet kontestuese ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe ka konstatuar se në v.q. "...", në ... e kanë shtëpi paditësi dhe i padituri, janë kufitar dhe pronat e tyre ndahen me një mur rrethues prej gurëve dhe betonit në lartësi afërsisht prej një (1) metër dhe gjatësi prej pesë (5) metra, në ngastrën e paditësit ku pretendohet se është bërë pengimi ajo pjesë është e shtruar me kubëza betoni dhe anësor betoni, ka ana lindore anësorët, janë larg prej murit rreth 15 cm, prej pjesës së sipërme të murit, shtëpia e të paditurit gjendje në anën lindore të ngastrës së paditësit, ishte e banueshme dhe për kah ndërtimi vërehej se është ndërtuar aty rreth viteve të '70-ta.

Në rastin konkret kabëzat e betonit ishin të vendosura, po ashtu edhe rrethojat gjegjësisht muri ishte i vendosur, por paditësi pretendon të vendos edhe një garazh në drejtim të shtëpisë së të paditurit gjegjësisht kah dritaret e tij.

Eksperti i gjeodezisë N.R. në seancën për shqyrtim kryesor pas këqyrjes së gjykatës në vendin e ngjarjes ka deklaruar se ngastrat kadastrale i ndanë muri, dhe se muri është lakuar – varur diku rreth 0.20 cm, në dëm të ngastrës së të paditurit për shkak të vjetërsisë.

Nga provat e administruara siq është marrëveshja gjyqësore e lidhur në mes të, të njëjtave palë ndërgjyqësore por me role të kundërta më datën 17.12.1980, këta kanë zhvilluar kontest gjyqësor për pengim posedimi, por paditës në atë kontest ka qenë Q.D. tani i paditur dhe i paditur ka qenë S.N. tani paditës, dhe para gjyqtarit ata kanë arritur marrëveshje gjyqësore ashtu që është detyruar atëherë i padituri tani paditësi që të mos ndërtoj objekt ndihmës në truallin e tij i cili mban numrin 1625/6, viza vi dritares së paditësit tani të paditurit në anën perëndimore të

ndërtesës së tani të paditurit, dhe pjesa jugore kah rruga e tërhequr viza vi dritares së ndërtesës së theksuar, muri i garazhës do të jetë i largua nga muri i ndërtesës së paditësit nga ana perëndimore 1.60 metra kjo me qëllim me ndërtimin e objektit ndihmës të mos ia zvogëloj dritën në dhomën e paditësit përkatësisht të mund ta shfrytëzoi në mënyrë komode tani i padituri dhomën.

Prandaj gjykata duke marr parasysh këtë fakt se vetë tani paditësi me ujdi gjyqësore ka marrë për detyrim që të mos e pengoi tani të paditurin duke iu ofruar objektin ndihmëse pran dritares së të paditurit, gjykata kërkesë padinë e tij e ka refuzuar si të pabazuar.

Paditësi duke marr parasysh këtë marrëveshje gjyqësore duhet t'i përmbahet asaj dhe në rast të ndërtimit të objekteve ndihmëse apo vendosjes së drunjve për ngrohje t'i përmbahet dimensioneve të përcaktuara me marrëveshje gjyqësore për më tepër duke u nisur edhe nga fakti se kabëzat e betonit vetëm ishin të vendosura në ngastrën e paditësit.

Andaj paditësi këtu nuk mund të gëzoi mbrojtje gjyqësore gjegjësisht të miratohet kërkesë padia e tij për një çështje ku ai ka lidhur marrëveshje gjyqësore dhe është pajtuar me kushtet nën të cilat është lidhë kjo marrëveshje.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur që ato të bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate pasi që paditësi nuk ka pasur sukses në kontest e në ndërkohë ai është i gjendjes së varfër ekonomike dhe për këtë është liruar nga taksat gjyqësore.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË

07.07.2014

Procesmbajtësi,
Ardian Sermahaj,d.v.

Gj y q t a r i,
Burim Shala, d.v.

Këshilla juridike – kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë në afat prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.